



Pranuar / Dorëzuar Primjenol/Prodato Received/Delivery		03-03-2023		viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSHICK	2309/2023		115	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.97/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari-anëtare dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtare, me Sabile Avdyli - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 97/2023 të datës 19.01.2023 të parashtruar nga ankuesja të cilën e përfaqëson Av. me adresë banimi Rr.“Bedri Gjinaj” H1/nr. 3 Mitrovicë, kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike “Masë Disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 03.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa numër A.nr.97/2023 e datës 19.01.2023 e parashtruar nga ankuesja
- II.**ANULOHET** Vërejtja me shkrim e datës 04.01.2023 me nr.01-116/01-0000438/23 e shqiptuar nga Udhëheqësja e Njesisë së Komunikimit Publikë në Komunën e Mitrovicës së Jugut.
- III.**Obligohet** Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të largoj nga dosja personale e nëpunëses Sofije Rushiti Peci si dhe regjistri përkatës masën disiplinore të anuluar si në pikën II.
- IV.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



## A r s y e t i m

Ankuesja , e punësuar në pozitën “Zyrtare për Informim” sipas Akt emërimit të datës 16.03.2020, në Komunën e Mitrovicës së Jugut, më datë 19.01.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” me numër reference 01-116/01-0000438/23 të datës 04.01.2023 nga Komuna e Mitrovicës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.01.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokoll 953/2023 tek organi i punësimit. Këshilli me datë 10.02.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë nga organi i punësimit me numër protokoll 1685/2023 bashkë me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 512/2023 të datës 19.01.2023 të parashtruar nga ankuesja të cilën e përfaqëson Avokat . në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizim; Vërejtje me Shkrim me numër reference 01-116/01-0000438/23 të datës 04.01.2023; Ankesën me numër 01-116/01-0001383/23 të datës 06.01.2023; Përgjigje në Ankesë me numër reference 01-116/01-0001383-2/23 të datës 10.01.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokoll 953/2023 të datës 26.01.2023; Përgjigje në ankesë e datës 10.02.2023 nga organi i punësimit me numër protokoll 1685/2023 bashkë me shkresat e lëndës; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Zyrtar për informim i datës 10.09.2021; Akt emërimi i datës 16.03.2020; Formulari për vlerësimin e punës provuese i datës 10.02.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil, dhe nëpunësve të Shërbimeve Publike për kategorinë drejtues i mesëm , i ulët dhe profesional për vitin 2022 i datës 09.01.2023; Komentet për vlerësim; Ankesë e datës 06.01.2023 me nr.01-116/01-0001383/23 e parashtruar në komisionin për ankesa në Komunën e Mitrovicës; kopja e letërnjoftimit; Përgjigje në ankesë e datës 10.01.2023 me nr.01-116/01-0001383-2/23 dhe Fletë Dorëzimi i datës 11.01.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjitha provave të parashtruar nga palët, konstatoi se ankesa e ankueses është e bazuar, sepse:

Udhëheqësja e Njesisë së Komunikimit Publikë në Komunën e Mitrovicës, ndaj ankueses Peci e cila mbanë pozitën : “Zyrtare për informim ”, me datë 04.01.2023 i ka shqiptuar masën disiplinore “Vërejtje me shkrim”, me dyshimin se e njëjta ka bërë shkelje të lehtë të detyrave të punës me arsyetimin se: “zyrtarja ka treguar mungesë të komunikimit, koordinimit dhe bashkëpunim joprofesional me mbikëqyrësen dhe bashkëpunëtorët tjerë të zyrës për komunikim me publikun”. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke trajtuar këtë pretendim ka konstatuar se me rastin e shqyrtimit të provave që lidhen me këtë ankesë nuk ka hasur në ndonjë provë as nga ankuesja as nga organi i punësimit që ka pas ndonjë ankesë me shkrim nga bashkëpunëtorët e ankueses në adresë të mbikëqyrëses së saj apo direktë edhe në adresë të ankueses në lidhje me çështjen bashkëpunimit joprofesional dhe ndërkolegjal, dhe në këtë kuptim pretendimi është i bazuar i ankueses sa i përket mungesës së argumentimit faktik në lidhje me këtë çështje.

Në “Vërejtjen me shkrim” e cila i është shqiptuar ankueses një nga argumentet që potencohet është fakti edhe i : “mbylljes së telefonit zyrtarë pasë orarit të punës” ,ndërsa nëse bazohemi në nenin 4 paragrafin 2 të



Rregullores NR. 07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publik, ku përcaktohet se : "2. Orari i punës së zyrtarëve publik fillon në orën 08:00 dhe përfundon në orën 16:00, pesë (5) ditë në javë duke filluar nga e hëna deri të premten, përveç nëse caktohet ndryshe nga institucioni përkatës për shkak të natyrës së punës", e mbi këtë bazë Këshilli nuk ka pas as një shkresë apo vendim që është dorëzuar nga ndonjë palë në këtë procedurë që e obligon Zyrtaren për Informim të veprorë ndryshe përveç kësaj që parasheh rregullorja e potencuar më lartë dhe në këtë kuptim nga organi i punësimit nuk është argumentuar fakti se ankuesja ka obligime zyrtare edhe pas orarit të punës, andaj shqiptimi i masës disiplinore "Vërejtje me shkrim" nga organi i punësimit nuk është i bazuar në ndonjë bazë të vetme ligjore apo në ndonjë akt administrativ të institucionit që obligon ankuesen që edhe pas orarit të punës të merret me obligime zyrtare poashtu me rastin e shqyrtimit të shkresave të lëndës kolegji i këshillit mori për bazë edhe përsëkrimin e vendit të punës të ofruar nga organi i punësimit, në të cilin përsëkrim nuk është hasur në ndonjë elementë në kuadër të objektivave të punës që e njëjta ka obligime zyrtare edhe pas orarit të punës.

Një nga arsyet tjera të vërejtjes me shkrim të shqiptuar nga Udhëheqësja e Njesisë së Komunikimit Publikë në Komunën e Mitrovicës në kuadër të mungesës së komunikimit dhe joprofesionalizimin sa i përket ankueses është është edhe fakti se ankuesja prej datës 14.12.2022 njofton mbikëqyrësen se gjindet në pushim mjekësor ndërsa me datën 16.12.2022 i është drejtuar zyrtarisht Kryetarit të Komunës së Mitrovicës përmes e-mailit zyrtar duke e njoftuar për Indeksën e Transparencës Buxhetore për vitin 2021 nga Instituti GAP, ku Institucioni në këtë rast Komuna e Mitrovicës është radhitur në vendin e parë. Kolegji i Këshillit konstaton se ky fakt nuk paraqet shkelje meqenëse ankuesja e ka vlerësuar si një të arritur të lartë të institucionit dhe e njëjta prej kur ka filluar punën në Komunën e Mitrovicës ka shkëmbyer në vazhdimësi e-maila me: kryetarin, nënkryetarin, kabinetin, drejtoritë dhe me nëpunësit tjerë të Institucionit dhe palët që i drejtohen Komunës së Mitrovicës me kërkesa të ndryshme, nga se këtë përgjegjësi e ka edhe konformë përsëkrimit të vendit të punës, dhe kolegji vlerëson se me qenë se nuk i është shkaktuar ndonjë pasojë komunës sa i përket këtij komunikimi nga se përmbajtja e njoftimit e tij përveç që është afirmative për institucionin ku punon ankuesja poashtu i është drejtuar zyrtarit kryesor administrativ të komunës dhe mbi këto elemente përkundër që ka qenë në pushim nuk mund të konsiderohet si ndonjë shkelje me qëllim që institucionit ti shkaktoj ndonjë dëm të caktuar, përkundër që është obligim i zyrtares që me rastin e komunikimeve zyrtare të ketë koordinim të ngushtë me mbikëqyrësen e saj.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar me ankesën e ankueses, konstaton se Udhëheqësja e Njesisë për Komunikim me Publikun, me rastin e shqiptimit të masës disiplinore nuk ka bërë vlerësim të drejtë të provave mbi bazë të cilave është vendosur për masën e shqiptuar e mbi këtë bazë edhe gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale në këtë rast, nuk ka arritur të konstatoj saktë elementet e përgjegjësisë disiplinore siç parashihet me nenin 45 dhe nenit 46 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se "4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar". Andaj kolegji i këshillit konstaton se përmbajtja e vendimit për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtja me shkrim" është e paqartë, jo i argumentuar, kundërthënës dhe i pakuptueshëm dhe nëse i referohemi Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenit 48 paragrafi 2 ku parashihet "2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i



barabartë me mungesën e tij”.

Siç u potencue më lartë Kolegji i këshillit me rastin e shqyrtimit të kësaj lënde dhe me rastin e vendimmarrjes për këtë ankesë ju referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik përkatësisht nenit 45 paragrafi 1, nënparagrafet 1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe 1.5 në të cilat dispozita parashihet “1. Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”, andaj referuar në këto dispozita ,nëse marrim për bazë provat që gjenden ne shkresat e lëndës të ofruara nga palët në këtë procedurë dhe përmbajtjen vendimit të atakuar të përmes kësaj ankese, kolegji i këshillit konstaton se nuk janë konsumuar elementet e një veprimi që cenon dispozitat që u potencuan më lartë nga ana e ankueses nga se me asnjë provë relevante mbikëqyrësja nuk ka arrit të argumentoj faktin e ekzistimit të veprimit të paligjshëm, fajësisë, pasojës së shkaktuar, dëmi që është shkaktuar si dhe ndërlidhjes së veprimeve të ankueses me qëllim të konsumimit të veprimeve të paligjshme ashtu siç parashihet në dispozitat e lartshënuara dhe që janë vendimtare për tu vërtetuar fajësia në këtë çështje, dhe në këtë kuptim pretendimi i ankueses është i bazuar nga se nuk është vërtetuar dhe argumentuar përmes këtij vendimit të atakuar se ankuesja me veprimet e saj ka cenuar dispozitat e potencuara si më lartë.

Nga ajo që u deklarue më lartë dhe mbi bazën e shkresave të lëndës mund të konstatohet se mbikëqyrësja përmes këtij vendimi të atakuar me rastin e shqiptimit të kësaj mase disiplinore respektivisht nga përmbajtja e vendimit të atakuar nuk ka marrë për bazë dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik që kanë të bëjnë me parimet e individualizimit të masave disiplinore përkatësisht nenin 50 paragrafi 1 nënparagrafi 1,1,1.2,1.3 dhe 1.4 ,nga se këto dispozita parashohin:”1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmi” andaj në këtë kuptim bazuar në vendimin e atakuar nga ankuesja, provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke marrë për bazë këto dispozita të potencuara më lartë, pretendimi ankimor i ankueses është i bazuar.

Kolegji me rastin e vendimarrjes në lidhje me këtë lëndë mori për bazë edhe formularin e vlerësimit të vitit 2022, Vlerësimi për vitin 2022 për ankuesen është nënshkruar me datën 09.01.2023 ndërsa vërejtja me shkrim i është shqiptuar me datën 04.01.2023, përkundër që janë të evidentuar disa mangësi në punën e ankueses në këtë vlerësim ,por se i njëjti nuk ishte i nënshkruar nga dy palët dhe poashtu ka një shkresë në shkresat e lëndës që ankuesja kontestonte vlerësimin,dhe me qenë kolegji vlerëson ka egzistuar e drejta e ankesës ndaj vlerësimit, nuk ka mundur të merrë për bazë vlerësimin e vitit 2022 me rastin e trajtimit të kësaj ankese.

Nga ajo që u deklarua më lartë dhe mbi bazën e shkresave të lëndës mund të konstatohet se Udhëheqësja e Njësisë për Komunikim me Publikun me rastin e shqiptimit të masës disiplinore respektivisht nga përmbajtja e vendimit të atakuar konstatohet fakti se vendimi i atakuar nuk përmban këshillën juridike si një nga elementet thelbësore/ të detyrueshëm të një akti administrativë ashtu siç parashihet te neni 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e që edhe në këtë kuptim këtë vendim e bënë të paligjshëm.





Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave mbi bazën e asaj që u potencua më lartë konstaton se Vendimi i datës 04.01.2023 me nr.01-116/01-0000438/23 e shqiptuar nga Udhëheqësja e Njesisë së Komunikimit Publikë në Komunën e Mitrovicës, është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe si i tillë ky vendim është shfuqizuar si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa ankesa e ankuesit është aprovuar si e bazuar për shkaqet e dhëna në arsyetimin e këtij vendimi.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, bazuar në arsyetimin e sipërm dhe si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyres për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.97/2023, datë 03/03/2023

Sabile Avdyli  
*Sabile Avdyli*  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit, Av.;
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Udhëheqësit të Njesisë të Burimeve Njerëzore të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Arkivit të KPMSHCK-së;